



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

P R O C E S V E R B A L NGA DEBATI PUBLIK PËR DRAFT PLANIN E PUNËS SË KUVENDIT KOMUNAL TË VITISË PËR VITIN 2022

Bazuar në vendimin për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë, vendimi me nr 01-110/05-471 i datës 29.06.2021, komisioni ka përgadit draft planin e punës, dhe bazuar në vendimin e Kuvendit komunal të Vitisë nr 01-110/05-615 të datës 31.08.2021, për shpalljen në diskutim publik, komisioni ka organizuar debat publik me qytetare, anetari i komisioni z.Fatlum Demiri të jete mbajtes i procesverbalit të ketij debati, në prezent të pjesmarrsve të cilet ishin në numër të pakët prezenton draft propozimi për planin e punës së Kuvendit, e bëri anëtari i komisioni z. Fatlum Demiri pas prezentimit hap debat për propozime të tjera, pasi që nuk ka për diskutim i njoftoj që ne e-mail adres ka pranuar një kerkese nga EULOC në Viti, që si pika në plan të punës të futen edhe tri propozime të cilat dërgohen në kuvend për miratim. Keto jane propozimet:

1. Diskutim lidhur me propozimin e një strategjie apo plani të punës lidhur me **pjesëmarrjen e qytetarëve me theks të vacant të grave në proceset vendimë marrëse në Komunën e Vitisë** (pjesëmarrje ne diskutime publike , dëgjime buxhetore, etj.) – Zyra e Kryetarit - muaji Maj
2. Kuvendi Komunal I Vitisë të propozoj në plan të punës “**Diskutim lidhur me Buxhetimin e drejtë gjinorë dhe planifikimi**” nga Drejtoria e Financave, para shqyrtimit dhe miratimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2022 dhe planifikimi I projeksioneve për vitin 2023-24. – muaji Qershor
3. Diskutim/Informatë lidhur me **zbatimin e rekomandimeve nga Raportit analitik i buxhetimit gjinor për vitin 2021 dhe planifikimi për vitin 2022** - Drejtoria e Financave – muaji Dhjetor

Pas perfundimit të debatit publik komisioni i rekomandon në Kuvendit Komunal të Vitise që ta miraton planin e punes së kuvendit komunal të Vitisë për vitin 2022.

Debati publik përfundoi me punë në ora 10:20 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri
